

## **PRIVATËSIA E TË DHËNAVE PERSONALE**

### **Njoftim për Privatësinë e të Dhënave Personale**

#### **I nderuari klient,**

Kompania e Sigurimeve "SAVA" Sh.a është e përkushtuar për të mbrojtur të dhënat tuaja personale dhe për të respektuar privatësinë tuaj. Mbrojtja e të dhënave tuaja personale është e rëndësishme për K.S SAVA dhe "Sava Insurance Group", pjesë e të cilit është K.S SAVA, që ka miratuar parime të fuqishme në këtë drejtim për gjithë grupin në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Ky njoftim për Mbrojtjen e të Dhënave ju ofron informata të detajuara lidhur me mbrojtjen e të dhënave tuaja personale nga K.S SAVA dhe në nivel të grupit ("ne"). Ne jemi përgjegjës, si kontrollues, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave tuaja personale lidhur me aktivitetet tona. Përpunimi i të dhënave tuaja personale bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij njoftimi është t'ju informojë për: Çfarë të dhëna personale mbledhim për ju; Arsyet pse i përdorim dhe i ndajmë këto të dhëna; Sa gjatë i mbajmë ato; Cilat janë të drejtat tuaja dhe si mund t'i ushtroni ato.

Ne mbetemi të përkushtuar për të siguruar që të dhënat tuaja personale të trajtohen me kujdes dhe të mbrohen në përputhje me standardet më të larta ligjore dhe etike.

### **1. ÇFARË TË DHËNA PERSONALE NE PËRDORIM PËR JU?**

Ne mbledhim dhe përdorim të dhënat tuaja personale deri në masën e nevojshme në kuadër të aktiviteteve tona dhe për të arritur standard të lartë të produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

Ne mund të mbledhim lloje të ndryshme të të dhënave personale për ju, duke përfshirë:

- Informatat e identifikimit (p.sh. emir dhe mbiemri, numri i letërnjoftimit dhe pasaportës, kombësia, vendi dhe data e lindjes, gjinia, fotografia, adresa IP)
- Informatat e kontaktit (p.sh. adresa postare dhe adresa e e-mailit, numri i telefonit)
- Gjendja familjare (p.sh. statusi martesor, numri i fëmijëve)
- Gjendja shëndetësore
- Informatat mbi arsimin dhe punësimin (p.sh. niveli i arsimit, punësimi, emri i punëdhënësit);
- Të dhënat bankare, (p.sh. numri llogarisë bankare)
- Informatat lidhur me aktivitetet tuaja digjitale (p.sh. adresa IP, aktiviteti i shfletimit ('browsing'), gjeo lokacioni etj.)
- të dhënat që kanë të bëjnë me përdorimin tuaj të produkteve dhe shërbimeve tona.
- të dhënat nga ndërveprimet tuaja me ne: degët tona (raportet e kontaktit), faqet tona të

internetit, aplikacionet tona, faqet tona të mediave sociale, takimet, thirrjet, bisedat, e-mailat, intervistat.

Ne nuk kërkojmë të dhëna personale që lidhen me origjinën tuaj racore ose etnike, opinionet politike, besimet fetare ose filozofike, anëtarësimin në sindikata, të dhënat gjenetike ose të dhënat lidhur me orientimin tuaj seksual, përveç nëse kërkohet me anë të një detyrimi ligjor.

Të dhënat që përdorim për ju mund të jepen drejtpërdrejt nga ju ose të merren nga burimet e mëposhtme për të verifikuar ose pasuruar bazat e të dhënave tona:

- Publikimet / bazat e të dhënave të vëna në dispozicion nga autoritetet zyrtare (p.sh. gazeta zyrtare)
- Klientët tanë të korporatave ose ofruesit e shërbimeve
- Uebfaqet / faqet e mediave sociale që përmbajnë informata të bëra publike nga ju (p.sh. uebfaqen tuaj ose mediat sociale) dhe
- Bazat e të dhënave të bëra publike nga palët e treta.

## **2. RASTET SPECIFIKE TË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PERSONALE, PËRFSHIRË MBLEDHJEN INDIREKTE TË TYRE**

Në rrethana të caktuara, ne mund të mbledhim dhe të përdorim të dhënat personale të individëve me të cilët kemi, mund të kemi ose kemi pasur marrëdhënie direkte, apo për shembull, klientët e mundshëm. Për disa arsye, ne po ashtu mund të mbledhim informata rreth jush, ndërsa ju nuk keni marrëdhënie të drejtpërdrejta me ne. Kjo mund të ndodhë, për shembull, kur punëdhënësi juaj të na japë informata për ju ose detajet e kontaktit tuaj ofrohen nga një prej klientëve tanë nëse jeni, për shembull:

- Anëtar i familjes
- Përfaqësues ligjor ose me autorizim
- Aksionar i kompanisë
- Përfaqësues i një entiteti juridik (i cili mund të jetë klient apo shitës)
- Punonjës i ofruesve të shërbimeve dhe partner tregtar
- Kontaktet personale.

## **3. PSE DHE NË ÇFARË BAZE NE PËRDORIM TË DHËNAT TUAJA PERSONALE?**

- I. Ne i përdorim të dhënat tuaja personale në përputhje me detyrimet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës dhe rregullativës së brendshme.  
Në raste të caktuara, ne duhet të kërkojmë pëlqimin tuaj për procesimin e të dhënave tuaja, të respektojmë zgjedhjen tuaj nëse kemi kërkuar pëlqimin tuaj për një procesim specific.

- II. Të dhënat tuaja personale në i përdorim për:

Të realizuar një kontratë me ju ose për të ndërmarrë hapa sipas kërkesës suaj para lidhjes së një kontrate në mënyrë që:

- Të ju ofrojmë informata lidhur me produktet dhe shërbimet tona;

- Të ju ndihmojmë dhe përgjigjemi në kërkesat tuaja;
- Të vlerësojmë nëse mund t'ju ofrojmë një produkt ose shërbim dhe në cilat kushte; dhe
- Të ofrojmë produkte ose shërbime për klientët tanë të korporatave tek të cilët ju jeni punonjës ose klient.

### III. Për të përmbushur interesin tonë legjitim

Ne përdorim të dhënat tuaja personale për të shpërndarë dhe zhvilluar produktet ose shërbimet tona, për të përmirësuar menaxhimin e rrezikut dhe për të mbrojtur të drejtat tona ligjore, duke përfshirë:

- Dëshminë e transaksioneve
- Parandalimin e mashtrimit
- Menaxhimin e TI, duke përfshirë menaxhimin e infrastrukturës (p.sh.: platformat e përbashkëta), vazhdimësinë e biznesit dhe sigurinë e TI;
- Personalizimin e ofertës sonë për ju
- Reklamimit të produkteve ose shërbimeve që përputhen me gjendjen dhe profilin tuaj.

## 4. ME KEND NE NDAJMË TË DHËNAT TUAJA PERSONALE?

Për të përmbushur qëllimet e lartpërmendura, ne shpalojmë të dhënat tuaja personale, por jo të kufizuara në:

- Kompaninë amë "Sava Insurance Group"
- Autoritetet financiare ose gjyqësore, agjencitë shtetërore ose organet publike, sipas kërkesës dhe në masën e lejuar me ligj
- Disa profesionistë rregullativ si avokatët, noterët, përmbartuesit privat, auditorët, zyrtarët tonë të mbledhjes së borxheve.

## 5. PËR SA KOHË NE MBAJMË TË DHËNAT TUAJA PERSONALE?

Ne do të mbajmë të dhënat tuaja personale për periudhë më të gjatë nga që kërkohet me qëllim që të jemi në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi ose ndonjë periudhë tjetër lidhur me kërkesat tona operacionale.

Kur ne nuk kemi nevojë të vazhdueshme të ligjshme të biznesit për të procesuar të dhënat tuaja personale, ne ose do t'i fshijmë ato apo i bëjmë anonime ose, nëse kjo nuk është e mundur, atëherë ne do t'i ruajmë në mënyrë të sigurt të dhënat tuaja personale dhe do t'i izolojmë ato nga çdo procesim mëtejshëm derisa fshirja të jetë e mundur.

## 6. CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA DHE SI MUND T'I USHTRONI ATO?

Në përputhje me rregulloret në fuqi, ju keni të drejtat e mëposhtme:

- Të keni qasje: mund të merrni informata lidhur me përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe një kopje të të dhënave të tilla personale
- Të korrighoni: kur mendoni se të dhënat tuaja personale janë të pasakta ose jo të plota, mund të kërkonti që të dhënat e tilla personale të ndryshohen siç duhet
- Të fshini: ju mund të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja personale, në masën e lejuar nga ligji
- Të kufizoni: ju mund të kërkonti kufizimin e procesimit të të dhënave tuaja personale
- Të kundërshtoni: ju mund të kundërshtoni procesimin e të dhënave tuaja personale, për arsye që lidhen me situatën tuaj të veçantë. Ju keni të drejtën absolute të kundërshtoni procesimin e të dhënave tuaja personale për qëllime të marketingut direkt, që përfshin profilizimin lidhur me një marketing të tillë direkt
- Të tërhiqni pëlqimin tuaj: nëse keni dhënë pëlqimin tuaj për procesimin e të dhënave tuaja personale, ju keni të drejtë të tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë
- Të bartni të dhënat: kur zbatohet në mënyrë të ligjshme, ju keni të drejtë të keni të dhënat tuaja personale që nakeni dhënë ne, që ato t'iu kthehen juve apo, kur është teknikisht e mundur, të transferohen tek një palë e tretë
- Në përputhje me rregulloren e zbatueshme, përveç të drejtave tuaja më sipër, ju po ashtu keni të drejtë të parashtroni një ankesë tek autoriteti kompetent mbikëqyrës.

## **7. SI MUND TË INFORMOHENI PËR NDRYSHIMET E BËRA NË KËTË NJOFTIM TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE?**

Në një botë me ndryshime të vazhdueshme teknologjike, ne mund të kemi nevojë të përditësojmë rregullisht këtë Njoftim për Mbrojtjen e të Dhënave.

Ne ju ftojmë të shqyrtoni versionin më të fundit të këtij njoftimi “online” dhe ne do t’ju informojmë ju për çdo ndryshim material nëpërmjet faqes sonë të internetit ose nëpërmjet kanaleve të tjera të zakonshme të komunikimit.

## **8. SI TË NA KONTAKTONI?**

Për çdo pyetje, shqetësim, kërkesë apo ankesë lidhur me politikën e privatësisë apo përdorimin e të dhënave personale, ju mund të kontaktoni përmes:

### **KRISTIAN GASHI**

Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

- **Email:** [data.protection@savasigurimi.com](mailto:data.protection@savasigurimi.com)
- **Tel:** +383 49 750 065